



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

**PA1 Nr. 0802-69**

**5.3.2024**

**Shkup**

Në mbështetje të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 2, neni 82, paragrafi (1) nënparagrafi 6 dhe neni 83 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), a në lidhje me nenin 80, paragrafi (5) të ligjit të njëjtë, nenit 51, paragrafi (1) dhe paragrafi (3) dhe nenit 52 paragrafi (2) të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr.124/15), nenit 28 të Ligjit të Kontesteve Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 96/19), nenit 24 të Rregullores së Procedurave të Punës Financiare dhe Kontabilitetit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, ark.nr.01-6222/1, datë 12.12.2014, duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr.0803-69, datë 19.2.2024 për inicim të procedurës për heqjen dhe Propozimin PA1 nr.0803-69 datë 29.2.2024 për miratim të vendimit për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion “RADIO USKANA – PLUS” eksport-import ShPKNJ, Kërçovë, a në pajtim me Konkluzionin, ark.nr. 0201-1054/12, datë 5.3.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 8-të, mbajtur me 4.3.2024, miratoi:

**VENDIM**

**për heqjen e lejes për transmetim në radio të**  
**Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion “RADIO USKANA – PLUS” eksport-import**  
**ShPKNJ, Kërçovë**

1. I HIQET leja për transmetim në radio PA1 nr. 08-105 datë 7.9.2023 të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion “RADIO USKANA – PLUS” eksport-import ShPKNJ, Kërçovë, për shkak të mospagesës së kompensimit vjetor për lejen e transmetimit në radio në afatin e përcaktuar ligjor - 30 ditë nga dita e pranimit të Faturës nr. 2024-100-0058, datë 11.1.2024 (nr ynë ark. 0503-227/1, datë 11.1.2024).

2. Fatura nr. 2024-100-0058, datë 11.1.2024 (nr. ynë ark. 0503-227/1, datë 11.1.2024), anulohet dhe subjektit nga pika 1 i këtij vendimi i jepet faturë e re, e cila i referohet vetëm periudhës së veprimtarisë, gjegjësisht deri në ditën e miratimit të këtij vendimi për heqjen e lejes, e cila duhet të paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së saj.

3. Ky vendim botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në uebfaqen e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra në gjuhën e bashkësive joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut

4. Ky Vendim është përfundimtar.

## Arsyetim

Shoqëria Tregtare për Radiodifuzion “RADIO USKANA – PLUS” eksport-import ShPKNJp, Kërçovë, është zotërues i lejes për transmetim në radio nr. 08-105, datë 7.9.2023, e cila transmeton program nëpërmjet radiofrekuencave, në nivel lokal (komuna e Kërçovës), shërbim programor radio folëse-muzikore me format të përgjithshëm në gjuhën shqipe.

Në pajtim me nenin 80, paragrafi (1) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV), për lejen për transmetim televiziv ose radio, transmetuesit, me përjashtim të shërbimit publik radiodifuziv, paguajnë kompensim vjetor në llogari të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në pajtim me këtë ligj. Kompensimi vjetor paguhet për çdo vit vijues, duke filluar nga data e dhënies së lejes për transmetim televiziv ose radio në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia (neni 80, paragrafi (5) të LShMAAV).

Në lidhje me kompensimin për lejen e transmetimit në radio të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion “RADIO USKANA – PLUS” eksport-import ShPKNJp, Kërçovë, nr. 08-105, datë 7.9.2023 Agjencia më 11.1.2024, ka dërguar Faturë nr 2024-100-0058, datë 11.1.2024 (nr ynë ark. 0503-227/1, datë 11.1.2024.) për kompensim të lejes, në pajtim me të cilën transmetuesi kishte detyrim që të paguante 22.106,00 (njëzet e dy mijë e njëqind e gjashtë) denarë për kompensim vjetor për lejen e transmetimit në radio, për periudhën nga 5.1.2024 deri më 4.1.2025. Në Agjenci është dorëzuar faturë kthyesë nga posta e Maqedonisë së RMV-së, se fatura është pranuar në rregull më 18.1.2024.

Në pajtim me nenin 27 paragrafi (1) të LSHMAAV, Agjencia kryen mbikëqyrje administrative, e cila kryhet mbi punën e botuesve të mediave nga aspekti i pajtueshmërisë së punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për media, Ligjin e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe rregulloreve të miratuara në bazë të tij (neni 29 paragrafi (1) të LSHMAAV).

Agjencia, përmes Sektorit të Financave dhe Logjistikës, ka kryer mbikëqyrje administrative të punës së Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion “RADIO USKANA – PLUS” eksport-import ShPKNJp, Kërçovë, nga aspekti i përmbushjes së detyrimit për pagesën e kompensimit vjetor për leje, nga ku pas kryerjes së mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative (nr. ynë ark. 0503-887/1, datë 19.2.2024), ka konstatuar se transmetuesi në fjalë nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 80, paragrafi (5) të LShMAAV, respektivisht nuk e ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio në llogari të Agjencisë.

Gjegjësisht, sipas faturës së dorëzuar nr. 2024-100-0058, datë 11.1.2024 (nr. ynë ark.0503-227/1, datë 11.1.2024), Shoqëria Tregtare për Radiodifuzion “RADIO USKANA – PLUS” eksport-import ShPKNJp, Kërçovë, ka pasur detyrim të paguajë 22.106,00 (njëzet e dy mijë e njëqind e gjashtë) denarë, për kompensim vjetor për lejen e transmetimit në radio, për periudhën nga 5.1.2024 deri më 4.1.2025. Që nga 16.2.2024, kur ishte afati i fundit ligjor për pagesë të kompensimit, Shoqëria Tregtare për Radiodifuzion “RADIO USKANA – PLUS” eksport-import, ShPKNJp, Kërçovë, nuk ka kryer pagesë në shumë prej 22.106,00 (njëzet e dy mijë e njëqind e gjashtë) denarë.

Përkatësisht, me datë 13.2.2024, ShTR “TELEVIZIONI USKANA MEDIA” ShPKNJp, Kërçovë, në llogari të Agjencisë, si kompensim vjetor për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion “RADIO USKANA-PLUS” eksport-import ShPKNJp, Kërçovë, me faturë nr. 2024-100-0058, datë 11.1.2024 (nr. ynë. ark. 0503-227/1, datë 11.1.2024 ), me koncesion ka paguar 22.106,00 denarë (njëzet e dy mijë e njëqind e gjashtë) denarë, mjete të cilat, Agjencia më 14.2.2024 i ka kthyer në llogari të

ShTR “TELEVIZIONI USKANA MEDIA! ShPKNjP, Kërçovë, për shkak se pagesa për transmetuesin Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion “RADIO USKANA – PLUS” eksport-import, ShPKNjP, Kërçovë, llogaria e të cilës është bllokuar, nuk mund të kryhet nga llogari e personi tjetër juridik, në pajtim me nenin 183, paragrafi (7) të Ligjit të Pagesave të Shërbimeve dhe Sistemeve Pagesore (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 90/22) – “personi juridik nuk mund të kryejë pagesë me përlllogari derisa ka xhirollogari të bllokuar”, dispozitat e të cilave zbatohen që nga 1 janar 2024.

Për sa më lart Agjencia drejtuar ShTR “TELEVIZIONI USKANA MEDIA” ShPKNjP, Kërçovë, dërgoi Shkresë (nr. ynë ark. 0503-792/1, datë 16.2.2024), që nuk do të jetë nënshkruar i koncesionit të dorëzuar, respektivisht i marëveshjes për tërheqje të kërkesës, sepse e njejta është kthyer.

Më 20.2.2024, personi fizik Munir Mehdiu në llogari të Agjencisë, si komnesim vjetor për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion “RADIO USKANA – PLUS” eksport-import, ShPKNjP Kërçovë, me faturë nr. 2024-100-0058, datë 11.1.2024 (nr. ynë. ark.0503-227/1, datë 11.1.2024), pagoi 22.106,00 denarë (njëzet e dy mijë e njëqind e gjashtë) denarë, mjete të cilat, Agjencia më 21.2.2024 i ktheu në llogari të personit fizik, sepse pagesa për transmetuesin, si person juridik nuk mund të kryhet nga llogaria e personit fizik. Për këtë pagesë, drejtuar Agjencisë është dorëzuar Informacion (nr.ynë.ark. 0503-1004/1 datë 26.2.2024), nga ana e personit fizik Munir Mehdiu.

Duke qenë se transmetuesi në fjalë nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor të paraparë në nenin 80, paragrafi (5) të LShMAAV, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio në llogari të Agjencisë, drejtori ka paraqitur në Këshillin e Agjencisë Propozimi PA1 nr. 0803-69, datë 29.2.2024, për miratimin e vendimit për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion “RADIO USKANA – PLUS” eksport-import ShPKNjP, Kërçovë.

Në nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 3 të LShMAAV-së, është përcaktuar se nëse konstatohet mosrepsektim, shkelje, cënim i dispozitave nga LShMAAV-ja dhe akteve nënligjore, miratuar nga Lijgi i njejtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë, kundër botuesi të medias, Këshilli i Agjencisë mund të ndërmer masë-heqjen e lejes.

Në pajtim me nenin 82, paragrafi (1), nënparagrafi 6 të LShMAAV-së, Agjencia do ta heqë lejen për transmetim televiziv dhe radio, para skadimit të afatit për të cilën është dhënë dhe do të fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve, paraprakisht duke i dorëzuar njoftim me shkrim, derisa zotëruesi i lejes nuk e paguan kompensimin e lejes në afatin e përcaktuar me ligj.

Procedua për heqjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, në pajtim me nenin 83, paragrafi (1) të LShMAAV, e inicon Këshilli me propozim të drejtorit të Agjencisë.

Duke pasur parasysh gjendjen e vërtetuar faktike, sipas së cilës zotëruesi i lejes, Shoqëria Tregtare për Transmetim “RADIO USKANA – PLUS” import-eksport, ShPKNjP Kërçovë, në afatin e përcaktuar ligjor prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk e ka përmbushur detyrimin nga neni 80, paragrafi (5) të LShAAV, gjegjësisht zotëruesi i lejes nuk e ka paguar kompensimin për lejen e transmetimit në radio në afatin e përcaktuar me ligj, personi i autorizuar nga ana e drejtorit të Agjencisë, në bazë të neni 83, paragrafi (1), a në lidhje me nenin 82, paragrafi (1), nënparagrafi 6 të LShMAAV, ka dorëzuar Propozim PA1 nr. 0803-69, datë 19.2.2024, për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion “RADIO USKANA – PLUS” eksport-import ShPKNjP, Kërçovë.

Këshilli i Agjencisë në seancën e 6-të, mbajtur më 19.2.2024, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr. 0201-773/14, datë 19.2.2024, miratoi Propozimin, PA1 nr. 0803-69, datë 19.2.2024, për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion “RADIO USKANA–PLUS” eksport-import ShPKNjP, Kërçovë.

Në lidhje me procedurën e iniciuar për heqjen e lejes të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion “RADIO USKANA – PLUS” eksport-import, ShPKNJ P Kërçovë, nr.08-105, datë 7.9.2023, dhe në pajtim me nenin 82, paragrafi (1) të LShMAAV-së, Agjencia ka dërguar Njoftim transmetuesit në fjalë (PA1 nr.0803-69, datë 21.2.2024), në të cilin i është thënë se nëse nuk paguan në tërësi kompensimin vjetor të lejes për të kryer transmetim në radio në pajtim me nenin 83 paragrafi (3) të LShMAAV-së, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, PA1 nr.0803-69, datë 19.2.2024, do të miratojë Vendim për heqje të lejes për transmetim në radio, pas së cilës në pajtim me nenin 85, paragrafi (2) të LShMAAV-së, transmetuesi do të fshihet nga regjistri i transmetuesve.

Njoftimi PA1 nr.0803-69, datë 21.2.2024 i është dërguar Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion “RADIO USKANA – PLUS” eksport-import, ShPKNJ P Kërçovë, me shkrim me postë rekomanduese. Duke qenë se Agjencia deri në marrjen e këtij Vendimi, nuk ka marrë rimbursim nga ShA Posta e RMV-së për pranim të Njoftimit (PA1 nr.0803-69, datë 21.02.2024), Agjencia ka kryer kontrollë në sistemin elektronik – ndjekje të dërgesave të ShA Posta e RMV-së nëpërmjet së cilës kontrollohet statusi i dërgesës, ku është konstatuar se për njoftimin e cituar nuk ka siguruar dëshmi për dorëzim të dërgesës të pranuesit. Nga komunikimi i lartpërmendur me transmetuesin, është evidente se ai ka qenë i njoftuar me përmbajtjen e Njoftimit PA1 nr. 0803-69, datë 21.2.2024, dhe i njëjti është dorëzuar edhe në formë elektronike në adresën elektronike zyrtare të transmetuesit të regjistruar si informatë për kontakt në RQRMV dhe në regjistrin e transmetuesve të udhëhequr nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 83 paragrafi (3) të LShMAAV, Këshilli është i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të propozimit të drejtorit për iniciim të procedurës për heqjen e lejes, të miraton vendim me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit..

Duke marrë parasysh faktin se zotëruesi i lejes, Shoqëria Tregtare për Radiodifuzion “RADIO USKANA – PLUS” eksport-import ShPKNJ P Kërçovë, nr. 08-105 datë 7.9.2023 dhe në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të Propozimit PA1 nr.0803-69, datë 19.2.2024, nga anëtarët e Këshillit të Agjencisë, nuk ka përmbushur detyrimin e parashikuar në nenin 80, paragrafi (5) të LShMAAV-së, drejtori i Agjencisë ka dorëzuar Propozim nr.0803-69 datë 29.2.2024. sipas së cilës Këshilli i Agjencisë, në bazë të nenit 82, paragrafi (1), nënparagrafi 6 dhe neni 83, paragrafi (3) të LShMAAV-së, dhe në pajtim me Konkluzionin e Agjencisë, ark.0201-1054/12 datë 05.03.2024, miratoi Vendim për heqjen e lejes nr.08-105, datë 07.09.2023 për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion RADIO USKANA - PLUS eksport-import ShPKNJ P, Kërçovë, për shkak se zotëruesi i lejes nuk e ka përmbushur detyrimin nga neni 80, paragrafi (5) të LShMAAV-së, respektivisht nuk ka paguar kompensimin e lejes për transmetim në radio në afatin e përcaktuar me ligj.

Në pajtim me nenin 24 të Rregullores për procedurat e veprimtarisë financiare dhe kontabël të Agjencisë, nëse zotëruesi i lejes për transmetim televiziv ose radio nuk kryen pagesën e kompensimit, sipas faturës së dorëzuar në afatin e përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni të Rregullores, e njëjta do të anulohet dhe do t'i jepet faturë e re që i referohet vetëm periudhës së veprimtarisë, e cila faturë paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së saj. Përndryshe, pagesa e borxhit, do të kryhet në rrugë gjyqësore.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, Fatura nr.2024-100-0058, datë 11.1.2024 (nr. ynë ark. 0503-227/1, datë 11.1.2024) për kompensimin të lejes për transmetim në radio, anulohet dhe Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion “RADIO USKANA – PLUS” eksport-import, ShPKNJ P, Kërçovë, i jepet faturë e re, që i referohet vetëm periudhës së funksionimit, pra deri në ditën e miratimit të këtij vendimi për heqjen e lejes dhe që do të duhet të paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së tij.

Në pajtim me nenin 84 të LShMAAV-së, vendimi për heqjen e lejes për transmetim në radio është përfundimtar, dhe kundër tij zotëruesi i lejes ka të drejtë padie

për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të vendimit. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

Bazuar në sa më sipër është marrë Vendim si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë Juridik:** Kundër këtij vendimi për heqjen e lejes, Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion “RADIO USKANA – PLUS” eksport-import, ShPKNJP, Kërçovë ka të drejtë të paraqesë padi për ngritje të kontestit administrativ, para gjykatës kompetente, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit.